



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 56, datë 22.12.2020

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT DHE PIKËZIMIT TË
KANDIDATURËS SË ZOTIT ALTIN BINAJ, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 22.11.2019
RISHPALLUR NË DATË 27.09.2019 DHE RISHPALLUR NË DATË 24.09.2020.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Fiona Papajorgji	- Anëtare
Arta Marku	- Anëtare
Miranda Andoni	- Anëtare
Saida Dollani	- Anëtare
Ludovik Dodaj	- Anëtar
Fatjona Memçaj	- Anëtare

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **znj. Katrin Treska**, përfaqësuese e autorizuar e Presidentit të Republikës,

- **zonjës Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës **22.12.2020**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDAT PËR GJYQTAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: **Z. Altin Binaj**

OBJEKTI:

Për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës së **z. Altin Binaj**, në vend vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur Presidenti i Republikës në datën **07.02.2018**, rishpallur në datë **27.09.2019** dhe rishpallur në datë **24.09.2020**.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtarëve relatorë të Këshillit, **znj. Vitore Tusha**,

mendimin e paraqitur nga **Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 39, datë 23.11.2020 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Altin Binaj për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datë 27.09.2019 dhe rishpallur në datë 24.09.2020, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj.

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, anëtarja e Këshillit, znj. Vitore Tusha, në cilësinë e relatorit të vendit vakantë përkatësisht të treguar në pikat 1 të këtij Vendimi, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati Altin Binaj në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, relatorja Vitore Tusha, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të këtij kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

4. Në përfundim të procedurave të verifikimit të të gjithë kandidatëve për vendin vakant, relatori përkatës znj. Vitore Tusha, ka paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për secilin kandidat të vendit vakant lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidaturave.

5. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga relatorja dhe plotësinë e dokumentacionin të paraqitur për vlerësim nga kandidati Altin Binaj, dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatit, me vendimin nr. 55, në datën 22.12.2020 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet vakante, si më poshtë:

- a) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datë 27.09.2019 dhe rishpallur në datë 24.09.2020.

6. Ndërkohë nga ana e Këshillit konstatohet se me vendimin nr. 77/2020, datë 17.12.2020 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka vendosur: “Zoti Altin Binaj zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.”.

7. Në datën 22.12.2020, ora 12:30 zoti Altin Binaj ka bërë betimin përpara Presidentit të Republikës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Pas betimit, në përputhje me nenin 129 të Kushtetutës, ky gjyqtar do të fillojë ushtrimin e detyrës së tij.

8. Me Deklaratën e datës 22.12.2020, pas bërjes së betimit, zoti Altin Binaj ka deklaruar heqjen dorë nga kandidimi për vakancën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datë 27.09.2019 dhe rishpallur në datë 24.09.2020, protokolluar në Këshill me nr. Prot. 539, datë 22.12.2020.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

9. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në raste të tilla.

10. Por, nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se:

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.

11. Anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, ka përgatitur relacionin e vlerësimit të kandidatit ku është përshkruar edhe procedura e zhvilluar deri në këtë moment, si dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të vlerësimit të kandidatit Altin Binaj për këtë vakancë, duke njoftuar Këshillin lidhur me vullnetin e shprehur nga ky kandidat.

12. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, si edhe në vetë formën e shprehjes së vullnetit nga kandidati në shqyrtim lidhur me vijimin e procedurave për vijimin e procedurave të vlerësimit dhe pikëzimit të këtij kandidati, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Altin Binaj.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 125 dhe të pikës 1 dhe të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 dhe 3 të nenit 229 dhe të nenit 239/2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Altin Binaj, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.

2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Altin Binaj.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVËNDËSKRYETARË

Vitore TUSHA

